Lajmet Operacionet

*25/02/2026*

# Elbasan/Finalizohet Operacioni I Koduar "Kamuflimi"

Elbasan

Finalizohet operacioni i koduar "Kamuflimi".

Strukturat e Policisë së Shtetit vijojnë kontrollet intensive për parandalimin dhe goditjen e çdo paligjshmërie që cenon rendin dhe sigurinë publike.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Elbasan, në bashkëpunim me Sektorin e Qarkullimit Rrugor, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Kamuflimi".

Si rezultat i këtij operacioni, u kap në flagrancë dhe u vu në pranga shtetasi E. E., 32 vjeç, banues në Peqin.

Ky shtetas u lokalizua në fshatin Bradashesh, duke drejtuar një automjet tip "Audi", në pjesën e përparme të të cilit kishte vendosur fenelina të ngjashme me ato të Policisë, me qëllim kamuflimin si mjet zyrtar dhe shmangien e kontrolleve nga shërbimet e Policisë.

Gjatë kontrollit në automjet, shërbimet e Policisë gjetën një armë zjarri pistoletë me fishekë, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, së bashku me fenelinat dhe automjetin.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Mbajtja pa të drejtë e uniformës".

Policia e Shtetit mbetet e angazhuar maksimalisht për të parandaluar çdo tentativë për të sfiduar autoritetin e ligjit dhe për të garantuar sigurinë e qytetarëve.

Raporti i ngjarjeve, 24 shkurt 2026

Korçë/Vijojnë takimet informuese dhe sensibilizuese në shkolla

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2026 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.